

VENDIM
Nr. 76, datë 22.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Sokol Berberi	anëtar i	“	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datat 29.9.2015 dhe 2.11.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 47 Akti, që i përket:

KËRKUES: Dod Gjoka

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Armando Gjeta, në mungesë, Komisioni i Ndarjes së Tokës Bashkia Laç, në mungesë, Zyra e Regjistrimit të Pasurisë Laç, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 232, datë 25.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini; nr. 1243, datë 1.11.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-3814, datë 10.12.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KENDJ); nenet 28, 29, 30 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.12.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuar pretendon se me aktin e marrjes së tokës në përdorim nr. 137, janar 1995 të Komisionit të Ndarjes së Tokës të fshatit Gjorëm-Kurbini është trajtuar, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”, me 9.2 dynym tokë bujqësore, të ndodhur në Gjorëm.

2. Edhe shtetasi Viktor Skeja (që ka ndryshuar më pas emrin në Armando Gjeta) është pajisur me po të njëjtin akt të marrjes së tokës në përdorim nr. 137, janar 1995.

3. Në këto rrethana, kërkuar i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini me kërkesëpadi me objekt kthim sendi, rivendosje në posedim, pavlefshmëri juridike të dhënies së tokës në pronësi dhe pavlefshmëri e certifikatës së pronësisë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbini, me vendimin nr. 232, datë 25.5.2001, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ajo ka arritur në përfundimin se akti i marrjes së tokës në përdorim nga kërkuar nuk ka vullnë e pushtetit lokal. Ndërsa shtetasit Armando Gjeta, edhe pse është pajisur me të njëjtin akt të marrjes së tokës në përdorim, në vitin 1996, ka marrë edhe aktin e dhënies së tokës në pronësi.

5. Mbi ankimin e kërkuarit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1243, datë 1.11.2001, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 232, datë 25.5.2001 të gjykatës së shkallës së parë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 412, datë 21.2.2003, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, gjithashtu, me vendimin nr. 37, datë 28.5.2004 ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të kërkuarit ndaj vendimit nr. 232, datë 25.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

8. Kërkuarisi ka marrë pjesë në cilësimin e paditësit edhe në procesin me palë Mrike Gjoka etj. dhe të paditur Armando Gjetën, Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me objekt deklarinimin të pavlefshëm të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 137 të vitit 1996. Në këtë proces, me vendimet nr. 50, datë 3.2.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe nr. 99, datë 21.9.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, të dyja gjykatat e faktit kanë vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi përbën gjë të gjykuar.

9. Kërkuarisi, gjithashtu, ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit Armando Gjeta për falsifikim dokumentesh, i cili është regjistruar si çështja penale nr. 43 e vitit 2005. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin me vendimin e datës 15.4.2005, ka vendosur pushimin e saj me argumentin se fakti nuk ekziston. Kundër këtij vendimi kërkuarisi ka bërë ankim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 71, datë 15.7.2005, ka pranuar kërkesën e tij. Sërish Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin e datës 24.6.2008, ka vendosur pushimin e çështjes sepse ndjekja penale është parashkruar. Edhe kundër këtij vendimi kërkuarisi ka paraqitur ankim dhe në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 137, datë 26.10.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, i cili ka vendosur pranimin e ankimit dhe vazhdimin e hetimeve të çështjes penale nr. 43, të viti 2005.

10. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin me vendimin e datës 28.9.2012, ka vendosur përsëri pushimin e çështjes penale. Ajo ka arsyetuar se shtetasi Armand Gjeta provohet se ka konsumuar elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, kryer kjo në formën e përdorimit të parashikuar nga neni 186/1 i KP-së, por referuar kohës së kryerjes së kësaj veprë, mbështetur në nenin 66/c të KP-së, sipas saj ndjekja penale për këtë veprë penale është parashkruar, pasi kanë kaluar më tepër se pesë vjet nga koha e kryerjes së veprës.

11. Bazuar në përfundimet e arritura në vendim nga prokurori, i cili ka vërtetuar faktin që shtetasi Armando Gjeta ka konsumuar elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim të vendimeve nr. 232, datë 25.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe nr. 1243, datë 1.11.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe të vendimeve nr. 50, datë 3.2.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe nr. 99, datë 21.9.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë të lartpërmendur.

12. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-201-3814, datë 10.12.2014, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të paraqitur nga kërkuarisi, me arsyetimin se në kuptim të neneve 494/ç dhe 495 të KPC-së nuk ekziston një vendim gjyqësor civil apo penal i formës së prerë që të vërtetojë rrethanën e falsifikimit të dokumenteve.

II

13. **Kërkuarisi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, duke parashtruar në mënyrë të përmblëdhur se:

13.1 Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur në kundërshtim të plotë me ligjin, duke bërë shkelje të rënda procedurale në cenim të parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

13.2 Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen me tre gjyqtarë, duke mos respektuar ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i cili parashikon se trupi gjyqësor në këto raste duhet të përbëhet nga pesë gjyqtarë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

14. Gjykata vlerëson se kërkuessi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, *ratione temporis*, vetëm për kërkimin për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, pasi për sa i përket kërimit për shfuqizimin e vendimeve nr. 232, datë 25.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe nr. 1243, datë 1.11.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pretendimi i tij është paraqitur tej afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

15. Kërkuessi pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, edhe pse neni 13/1 i ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i përditësuar, parashikon se trupi gjykues në këto raste duhet të përbëhet nga pesë gjyqtarë.

16. Lidhur me pretendimin për formimin e drejtë të trupit gjykues, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Termi “gjykatë” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 16 datë 27.3.2012, nr. 23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata konstaton se neni 13/1 i ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i përditësuar, të cilit i referohet kërkuessi, parashikon se kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, përveçse kur legjislacioni procedural në fuqi parashikon ndryshe. Edhe neni 35/5 i KPC-së parashikon se Gjykata e Lartë gjykon në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që, sipas këtij neni, në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga një gjyqtar. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.

18. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata vlerëson se kërkesat për rishikim në Gjykatën e Lartë, duke qenë mjete të jashtëzakonshme ankimi, në çdo rast, duhen shqyrtuar nga një trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.

19. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar kërkesën për rishikim me një trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se gjatë shqyrtimit të çështjes nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, trupi gjykues nuk është formuar komform parashikimeve ligjore të nenit 13/1 i ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 të lartpërmendur.

20. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuessit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i bazuar dhe duhet pranuar.

C. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit

21. Kërkuessi, gjithashtu, pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në kundërshtim me ligjin dhe me parimet e procesit të rregullt ligjor, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të paraqitur prej tij edhe pse organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka konstatuar në vendimin e pushimit të datës 28.9.2012 se subjekti i interesuar Armando Gjeta ka konsumuar elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve.

22. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ajo i vlerëson pretendimet e individëve në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe detyrimin që kanë

gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për respektimin e tyre. Gjykata ka vlerësuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjithashtu, bazuar në parimin *jura novit curia* Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pavarësisht nga mënyra e formulimit të kërkesës, pretendimi i kërkuarit se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur në kundërshtim me ligjin, duke bërë shkelje të rënda procedurale në cenim të parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhet të trajtohet në këndvështrim të respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 41, datë 28.9.2011; nr. 21, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Nga ana tjetër, lidhur me kërkesën për rishikim, Gjykata është shprehur se ajo përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale (neni 494 i KPC-së) përkatëse (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë bazohet në faktin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, në vendimin e pushimit të çështjes në ngarkim të shtetasit Armando Gjeta, ka konfirmuar se ai me veprimet e tij ka konsumuar elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, në të cilat janë bazuar gjykatat në marrjen e vendimeve të tyre. Ky fakt, sipas kërkuarit, ishte i mjaftueshëm për të shërbyer si shkak ligjor që Gjykata e Lartë të vendoste pranimin e kërkesës për rishikim, sepse sipas nenit 494/ç të KPC-së kur “*vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara*”, Gjykata e Lartë duhet të vendosë rishikimin e çështjes.

28. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se neni 494/ç i KPC-së duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me nenin 495 të KPC-së, sipas të cilit

rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 494 të KPC-së lejohen kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë dhe në këto kushte vendimi i pushimit të prokurorit nuk mund të shërbejë si shkak për rishikimin e vendimeve gjyqësore.

29. Për sa i përket vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Kur ushtron ndjekjen penale prokurori mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale, apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Gjykata, në përfundim të procesit, vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë se në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal, është ajo që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori (*shih vendimin nr. 5, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se interpretimi i ligjit procedural është atribut i gjykatave të sistemit gjyqësor dhe i organeve që e zbatojnë atë. Nisur nga ky parim, edhe sqarimi i kuptimit të çdo dispozite të KPP-së dhe raporti i saj me dispozitat e tjera të përafërta me të për zbatimin e tyre në gjykimet e çështjeve është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr. 20, datë 29.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i lartpërmendur i Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin nr. 28*) është brenda kompetencave që ligji procedural i atribuon asaj Gjykate, dhe në këtë kuptim pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-3814, datë 10.12.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Pajtohem me vendimin e shumicës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-3814, datë 10.12.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por në ndryshim nga shumica mendoj se duhej pranuar edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të kërkuesit, për arsye të mëposhtme:

2. Sikurse ka theksuar edhe shumica (*shih paragrafin nr. 25 të vendimit*), Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të

filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 41, datë 28.9.2011; nr. 21, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 15, datë 17.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në të njëjtën linjë është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese Gjermane. Sipas jurisprudencës së saj gjykatat nuk mund të injorojnë detyrimin për të respektuar të drejtën e aksesit të individit në gjykatë, përkundrazi ato duhet ta garantojnë atë në çdo moment dhe të marrin të gjitha masat që ajo të realizohet pavarësisht situatës juridike (BVerfGE 29, 45).

5. Ndërsa lidhur me kërkesën për rishikim, Gjykata ka vlerësuar se ajo përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale (neni 494 i KPC-së) përkatëse (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Po në këtë drejtim, GJEDNJ-ja (*çështja Bujnita kundër Moldavisë, 16 janar 2007 dhe çështja Xheraj kundër Shqipërisë, 29 korrik 2008*) ka theksuar se autoriteti që ushtron kompetencën e rishikimit të një akti ose procesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur një balancë të drejtë midis interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë (*shih edhe vendimin nr. 5, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në rastin në shqyrtim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, në vendimin e pushimit të çështjes në ngarkim të subjektit të interesuar, ka konfirmuar faktin se ky i fundit me veprimet e tij ka konsumuar elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, të cilat janë bazuar gjykatat në marrjen e vendimeve të tyre. Bazuar mbi këtë rrethanë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e saj me arsyetimin se, në kuptim të neneve 494/ç dhe 495 të KPC-së, nuk ekziston një vendim gjyqësor civil apo penal i formës së prerë që të vërtetojë rrethanën e falsifikimit të dokumenteve. Sipas Gjykatës së Lartë efektet e vendimit të pushimit të prokurorit nuk mund të barazohen me ato të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

8. Shumica në vendimin e saj ka vlerësuar se ky arsyetim i Gjykatës së Lartë është brenda kompetencave që ligji procedural i atribuon asaj gjykate, dhe në këtë kuptim pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit nuk hyn në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafin nr. 30 të vendimit*).

9. Ky arsyetim i shumicës më duket formal dhe nuk përmbush kriteret kushtetuese të trajtuara më lart lidhur me detyrimin që kanë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, që pavarësisht situatës juridike të marrin të gjitha masat që e drejta e aksesit të garantohet efektivisht. Në këtë kuptim Gjykata e Lartë ishte e detyruar që brenda kriterëve ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile të gjente hapësirat për respektimin e së drejtës së aksesit të kërkuarit.

10. Gjykata e Lartë, përkundrazi, ndonëse pranon faktin e konstatuar nga prokuroria për falsifikimin e dokumenteve që lidhen me zgjidhjen e konfliktit në fjalë, nuk ka bërë asnjë përpjekje për të vënë në diskutim nëse ky fakt përbën një *“rrethanë të re apo provë të re me shkruesë”*, në kuptim të shkronjës “a” të nenit 494 të KPC-së, ku thuhet shprehimisht se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë kur *“zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkruesë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj”*. Në këndvështrimin tim, përderisa kërkuari i ka përdorur të gjitha mjetet në dispozicion për të kërkuar të drejtën e tij të pronësisë, situata që vepra penale është parashkruar nuk mund ta cenojë atë në të drejtën e tij, kur është provuar tashmë nga vendimi i prokurorisë që subjekti i interesuar e ka fituar pronësinë mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, rrethanë kjo që nuk dihej në kohën e shqyrtimit të çështjes.

11. Nga sa më lart, ndryshe nga shumica, jam i mendimit që çështja hyn në juridiksionin kushtetues, pasi në rastin konkret interpretimi i ligjit (neni 494 i KPC-së) është i lidhur ngushtë me cenimin e së drejtës kushtetuese të aksesit në gjykatë. Sipas jurisprudencës konstante të Gjykatës kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete përbëjnë juridiksion kushtetues, kur ato shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Si përfundim, mendoj se vendimi i Gjykatës së Lartë, krahas parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të evidentuar nga shumica, i ka cenuar kërkuarin edhe të drejtën e aksesit në gjykatë.

Anëtar: Vladimir Kristo